**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

**DEGA VENDORE DURRËS**

**NOTER DIANA F. HOXHA**
**ADRESA NR.4/RAJONI 1,**
**SKENDERBEJ/EGNATIA, PALLATI**
**1182**
**TEL: 697879369**

# VERTETIM NENSHKRIMI

(STATUTI)

**Nr. repertori: 119** / 1

**Durres më 18/01/2021**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

V20210109000005369578

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE DURRËS**
**NOTER DIANA F. HOXHA**

V2021010900005369578

## VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 18.01.2021, para meje Notere DIANA F. HOXHA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durres, NR.4/RAJONI 1, SKENDERBEJ/EGNATIA, PALLATI 1182, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUES/IT**:

MAURIZIO AMBROSINI, atësia Luciano, amësia LUISELLA, shtetas Shqiptar, lindur në BOLZANO dhe banues në ITALI, me adresë Rocchetta Nervina (18030 - Im), Italia, lindur më 22/12/1958, gjendja civile "I MARTUAR", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte Tjeter nr. YA9252750 dhe nr. personal YA9252750 , .

Subjekti i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkroi përpara meje Noteres, "Statut OUTBOUND network&solutions", bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 *"Për Noterinë"*, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**
DIANA F. HOXHA

**S T A T U T I**

**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

# "OUTBOUND network&solutions " SHPK

## KAPITULLI I

## DISPOZITA TE PERGJITHSHME

### NENI 1

Me Akt Themelimi te dates 18.01.2021 midis:

**MAURIZIO AMBROSINI**, shtetas italian, i biri i Luciano, i datelindjes 22.12.1958, lindur ne Bolzano,Itali dhe banues ne Rocchetta Nervina (18030 - IM), Italia, mbajtes i pasaportes italiane me numer YA9252750 e vlefshme deri me 18.04.2026, themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emertuar **"OUTBOUND network&solutions" shpk.**

### NENI 2

Shoqeria "**OUTBOUND network&solutions**" shpk, eshte nje person juridik i te drejtes shqiptare qe operon si e tille nga dita e regjistrimit ne regjistrin tregetar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit si dhe organeve fiskale.
Aktiviteti i saj do te rregullohet konform dispozitave te ketij Statuti date 18.01.2021, te Aktit te Themelimit bashkangjitur dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi.
Kohezgjatja e aktivitetit fiksohet deri me 31 Dhjetor 2039, por mund te shtyhet ne unanimitet nga ortaket.

### NENI 3

### Objekti i aktivitetit

Projektim, blerje ,shitje pasuri te paluajteshme, rikonstruksione, ndertimtari dhe cdo aktivitet tregtar që nuk ndalohet me ligj dhe eshte në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme.

### NENI 4

**Selia Qendrore** e Shoqërisë është në adresën: Lagja 4, rruga „Egnatia",, zk. 8514, Flag Ship Center, Durres. Asamblea e ortakeve ka te drejte te hape filiale e zyra perfaqesie si dhe t'i shkrije ato.

## KAPITULLI II

## KAPITALI SHOQEROR DHE KUOTAT

### NENI 5

**Kapitali shoqeror fillestar** eshte ne vleren 100'000 Lek ( njeqindmije),e barabarte me 1 (nje) kuote, Maurizio Ambrosini =1 kuote=100'000 lek = 100% e kapitalit.

### NENI 6

Kuotat e kapitalit mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

a. kontributit ne kapital,

b. shitblerjes,
c. trashegimise
d. dhurimit
e. cdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj.

Kalimi i kuotave behet me ane te nje kontrate me shkrim.

**ART. 7**

**Organi vendimmarres**

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
b) ndryshimet e statutit;
c) emerimin e administratoreve;
d) emerimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
e) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjen "c" dhe "d" te kesaj pike.
f) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
gj) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
h) pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
i) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
j) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
k) miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese;
l) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

**NENI 8**

Rritja e kapitalit vendoset nga Asamblea e Ortakeve.

Pas vendimit te asamblese per rritjen e kapitalit, ortaku, brenda 10 diteve, duhet te bej derdhjen respektive.

Pas derdhjes se kontributeve te siperpermendur, Administratori i Vetem duhet te regjistroje rritjen e kapitalit.

## KAPITULLI III
## ASAMBLEA E PERGJITHSHME

**NENI 9**

**Asamblea e Pergjithshme** eshte organi me i larte vendimmarres i shoqerise dhe perfaqeson teresine e ortakeve.

Vendimet e saj merren konform legjislacionit ne fuqi e ketij statuti dhe jane te detyrueshme. Ato verbalizohen ne nje regjister te veçante siç e kerkon ligji. Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme.

**ART. 10**

Asamblea e Pergjithshme vendos per :

- politikat tregetare,
- ndryshimet ne Statut,
- emerimin, shperblimin e shkarkimin e Administratorit te Vetem, te likuidatorit apo Ekspertit Kontabel te Autorizuar (EKA),
- Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregetare nga administratori, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
- zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit,
- ndarjen e fitimeve te mundshme sipas nenit 76,77,78 te ligjit dhe krijimin e rezervave,
- trasferimin dhe cedimin e kuotave,
- perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj Administratorit,
- riorganizimin dhe prishjen e shoqerise,
- miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te Asamblese.

**NENI 11**

Asamblea e pergjithshme mund te mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligji dhe çdo here qe konsiderohet e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise, por te pakten nje here ne vit.

Thirrjet e Asamblese behen nen kujdesin e Administratorit te Vetem me leter rekomande ose me poste elektronike te pakten 7 dite te plota para mbledhjes. Njoftimi duhet te permbaje rendin e dites, daten, oren dhe vendin e mbledhjes.

**NENI 12**

Ortaku mund te perfaqesohet me nje autorizim, i vlefshem vetem per nje mbledhje, qe perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite, nga nje i trete qe nuk eshte Administratori i Vetem.

I takon Administratorit te Vetem te konstatoje te drejten e pjesemarrjes.

Cdo kuote te jep te drejten e nje vote.

Ortaku ose perfaqesuesi i saj mund te marr pjese edhe nepermjet mjeteve elektronike, perfshire telekonferencen, audio ose audio-video konform nenit 88 te ligjit.

**NENI 13**

Asamblea drejtohet nga Administratori i Vetem; ne mungese pjesemarresit me shumice te kapitalit te perfaqesuar zgjedhin nje drejtues.

Asamblea emeron edhe nje sekretar.

Vendimet e Asamblese nenshkruhen nga te gjithe ortaket prezente ose te deleguarit e tyre.

Kur ligji e parashikon, si dhe kur Administratori i Vetem e konsideron te arsyeshme, verbali hartohet nga nje noter.

**NENI 14**

Te gjitha vendimet e Asamblese se pergjithshme regjistrohen ne procesverbale te cilet ruhen nen pergjegjesine e Administratorit te Vetem.

Ne procesverbalin qe permban daten dhe vendin e mbledhjes, rendin e dites, emrat e atij qe drejton mbledhjen e te atij qe mban procesverbalin dhe rezultatet e votimit, bashkangjitet lista e pjesemarresve si dhe akti i thirrjes se Asamblese se pergjithshme.

Procesverbalet e mbledhjes nenshkruhen kryetari dhe mbajtesi i procesverbalit.

## NENI 15

Ne rastin e vendimeve qe kerkojne nje shumice te zakonshme, Asamblea e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave e kapitalit.
Ne rastin e vendimeve qe kerkojne nje shumice te kualifikuar, Asamblea e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese personalisht ortaket qe zoterojne me shume se 50% te votave.
Nese Asamblea e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur me siper, Asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

## NENI 16

Asamblea e pergjithshme vendos me 3/4 e votave te ortakeve pjesemarres, per ndryshime ne statut, rritje apo zvogelim te kapitalit te shoqerise, ndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe shkrirjen e shoqerise.
Per ceshtjet e tjera te parashikuara nga neni 10 i ketij statuti Asamblea e pergjithshme vendos me shumice te zakonshme.

## NENI 17

Asamblea e pergjithshme gezon te drejten t'i kerkoje Gjykates anullimin e vendimeve te administratorit kur keto shkojne kunder legjislacionit ne fuqi apo ketij statuti.
Eshte Asamblea qe ngarkon se kush do ta perfaqesoje shoqerine ne Gjykate.
Te drejtat e te treteve mbeten te paprekura ne te tilla raste.

# KAPITULLI IV

# ADMINISTRIMI

## NENI 18

Administrimi si dhe perfaqesimi i shoqerise i besohen nje ***Administratori te Vetem***, qe mund edhe te mos jete ortak.
Administratori i Vetem emerohet per 5 vjet nga regjistrimi i shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, me perjashtim doreheqje apo shkarkimi nga ana e Asamblese.
Me vendim unanim te Asamblese, detyra e **Administratorit te Vetem** i ngarkohet **z.** Maurizoi Ambrosini, te cilit i jepet e drejta e firmes dhe e perfaqesimit te shoqerise.

## NENI 19

Administratori i Vetem ka te gjithe kompetencat per realizimin e objektit te shoqerise, me perjashtim te kompetencave te dhena nga Akti i Themelimit dhe nga ky Statut ekskluzivisht Asamblese se pergjithshme.
Administratori i Vetem kane te drejte dhe detyrohen te :

→ administroje veprimtarine tregetare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregetare,
→ te perfaqesoje shoqerine,
→ te kryeje te gjitha levizjet e nevojshme per administrimin e zakonshem te aktivitetit konform politikave dhe strategjive te vendosura nga Asambleja e pergjithshme dhe te raportoje per realizimin e tyre,
→ te kujdeset qe dokumentacioni ne pergjithesi dhe librat kontabel te mbahen te rregullt dhe konform normale ligjore ne fuqi,

→ te pergatise dhe te nenshkruaje bilancin vjetor dhe raportin e ecurise se veprimtarise, dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, ia paraqet Asamblese per miratim.

→ te krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise,

→ te kryej regjistrimet e parashikuara nga ligji prane Qendres Kombetare te Regjistrimeve.

→ Administratori ka te drejte cdc te muaj te raportoje tek ortaket gjendjen financiare te shoqerise, duke paraqitur dokumentat kontabel te azhornuara.

Te drejtat dhe detyrimet e Administratorit te Vetem si dhe çdo ndryshim i tyre do te paraqiten prane Qendres Kombetare te Regjistrimit per t'u regjistruar.

**NENI 20**

Shperblimi i Administratorit te Vetem vendoset nga Asambleja dhe duhet te jete i pershtatshem dhe ne perputhje me detyrat e tij dhe gjendjen finanziare te shoqerise.
Nese shoqeria eshte ne veshtiresi finanziare, Asamblea mund te vendose reduktimin e shperblimit te Administratorit.
Kriteret e shperblimit, shperblimi individual dhe efekti vjetor i shperblimit te Administratorit ne strukturen e kostove te shoqerise tregetare publikohen se bashku me pasqyrat financiare vjetore.

**NENI 21**

Administratori i Vetem detyrohet te :

a. te kryejne detyrat e percaktuara nga ligji dhe nga ky statut ne mirebesim dhe ne interesin me te mire te shoqerise, duke i kushtuar vemendje te veçante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis,
b. te ushtroje kompetencat qe i njihen me ligj ose ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara,
c. te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet per te cilat do marre vendim,
ç. te parandaloje dhe te menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ato te shoqerise,
d. te garantoje miratimin e marreveshjeve sipas dispozitave te pikes 3 te nenit 13 te ligjit per rastet e konfliktit te interesit,
e. te ushtroje detyren e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e duhur.
f. Leshon certifikaten e aftesise paguese te shoqerise e cila konfirmon qe dividentet e propozuar plotesojne kerkesat e ligjit.

**NENI 22**

Administratori i Vetem, gjate detyres se tij, pergjigjet para shoqerise apo te treteve qe pesojne deme nga mosrespektimi i ligjit, Aktit Themelues apo ketij Statuti.
Administratori i Vetem pergjigjet personalisht, financiarisht por jo vetem, para shoqerise dhe/ose te treteve qe kane pesuar deme nga ndonje veprim i tij jo ligjor.
I takon Administratorit te Vetem te demostroje qe ka kryer detyren e tij ne menyre te rregullt dhe konform normave te kerkuara.
Administratori i Vetem pergjigjet para shoqerise per vlefshmerine e certifikaten e aftesise paguese te shoqerise te leshuar nga ai vete.

**NENI 23**

Administratori i Vetem mund te shkarkohet me vendim te Asamblese se ortakeve ose me vendim te Autoritetit Gjyqesor.

**KAPITULLI V**

→ te pergatise dhe te nenshkruaje bilancin vjetor dhe raportin e ecurise se veprimtarise, dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, ia paraqet Asamblese per miratim.

→ te krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise,

→ te kryej regjistrimet e parashikuara nga ligji prane Qendres Kombetare te Regjistrimeve.

→ Administratori ka te drejte cdc te muaj te raportoje tek ortaket gjendjen financiare te shoqerise, duke paraqitur dokumentat kontabel te azhornuara.

Te drejtat dhe detyrimet e Administratorit te Vetem si dhe çdo ndryshim i tyre do te paraqiten prane Qendres Kombetare te Regjistrimit per t'u regjistruar.

**NENI 20**

Shperblimi i Administratorit te Vetem vendoset nga Asambleja dhe duhet te jete i pershtatshem dhe ne perputhje me detyrat e tij dhe gjendjen finanziare te shoqerise.

Nese shoqeria eshte ne veshtiresi finanziare, Asamblea mund te vendose reduktimin e shperblimit te Administratorit.

Kriteret e shperblimit, shperblimi individual dhe efekti vjetor i shperblimit te Administratorit ne strukturen e kostove te shoqerise tregetare publikohen se bashku me pasqyrat financiare vjetore.

**NENI 21**

Administratori i Vetem detyrohet te :

a. te kryejne detyrat e percaktuara nga ligji dhe nga ky statut ne mirebesim dhe ne interesin me te mire te shoqerise, duke i kushtuar vemendje te veçante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis,

b. te ushtroje kompetencat qe i njihen me ligj ose ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara,

c. te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet per te cilat do marre vendim,

ç. te parandaloje dhe te menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ato te shoqerise,

d. te garantoje miratimin e marreveshjeve sipas dispozitave te pikes 3 te nenit 13 te ligjit per rastet e konfliktit te interesit,

e. te ushtroje detyren e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e duhur.

f. Leshon certifikaten e aftesise paguese te shoqerise e cila konfirmon qe dividentet e propozuar plotesojne kerkesat e ligjit.

**NENI 22**

Administratori i Vetem, gjate detyres se tij, pergjigjet para shoqerise apo te treteve qe pesojne deme nga mosrespektimi i ligjit, Aktit Themelues apo ketij Statuti.

Administratori i Vetem pergjigjet personalisht, financiarisht por jo vetem, para shoqerise dhe/ose te treteve qe kane pesuar deme nga ndonje veprim i tij jo ligjor.

I takon Administratorit te Vetem te demostroje qe ka kryer detyren e tij ne menyre te rregullt dhe konform normave te kerkuara.

Administratori i Vetem pergjigjet para shoqerise per vlefshmerine e certifikaten e aftesise paguese te shoqerise te leshuar nga ai vete.

**NENI 23**

Administratori i Vetem mund te shkarkohet me vendim te Asamblese se ortakeve ose me vendim te Autoritetit Gjyqesor.

**KAPITULLI V**

## NENI 24

Viti ekonomik ushtrimor fillon nga data e rregjistrimit.
Ne fund te çdo ushtrimi do te hartohet bilanci dhe pasqyrat e tjera vjetore konform legjislacionit ne fuqi.

## NENI 25

Asamblea pas aprovimit te bilancit dhe pasqyrave financiare, brenda dates 30 qershor vendos mbi sjelljen me fitimin.
Shoqeria mund t'u shperndaje fitime ortakut, vetem nese pas pagimit te dividentit :

a. Aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e saj,
b. Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve ne vazhdim.

# KAPITULLI VI

# PRISHJA DHE LIKUJDIMI

## NENI 26

Akti Themelues,Statuti dhe aktet e tjera te shoqerise mund te konsiderohen te pavlefshem vetem ne rast se shkelin dispozitat e parashikuara ne ligjin n. 9901( i ndryshuar) dt. 14.04.2008 " Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare " ose ne Kodin Civil.

## NENI 27

Shoqeria prishet vetem nese :

- skadon afati i parashikuar ne Aktin e Themelimit dhe ne kete Statut,
- me vendim te Asamblese se pergjithshme,
- me hapjen e procedurave te falimentimit,
- nese nuk ka kryer veprimtari tregetare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, sipas normave ligjore ne fuqi,
- me vendim te Gjykates.

## NENI 28

Me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi, prishja e shoqerise ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimit sipas legjislacionit ne fuqi.

## NENI 29

Me fillimin e procedurave te likujdimit Asamblea e pergjithshme emeron likuidatorin e shoqerise, te drejtat dhe detyrimet per te perfaqesuar shoqerine si dhe shperblimin e tij.
Administratori i Vetem paraqet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit te dhenat e likuidatorit dhe dokumentat qe lidhen me te.
Likuidatori depoziton prane Qendres Kombetare te Regjistrimit firmen e tij dhe ne vazhdim deklaron atje çdo ndryshim te mundshem qe ka lidhje me identitetin apo kompetencat e likuidatorit.
Likuidatori zevendeson Administratorin e Vetem me te gjithe kompetencat e tij nga dita e emerimit te tij.

## NENI 30

Persa nuk specifikohet shprehimisht ne kete statut, vlejne normat e legjislacionit shqiptar ne fuqi.

**NENI 31**

Ky Statut ne gjuhen shqipe do te kete bashkangjitur kopjen ne gjuhen italiane.

**NENI 32**

**Baza ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjslacionit shqiptar

Per sa nuk parashikohet ne kete statut do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodi Civil dhe cfardo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise..

**NENI33**

**Mosmarreveshjet**

Per mosmareveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente gjykata shqiptare.

**ORTAKU**

**MAURIZIO AMBROSINI**

Ky akt nenshkruhet ne prani te perkthyesit ligjor te njohur ne Ministria e Drejtesise

Oert Vezi.